

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6103
E mërkurë, 2 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Covid-19 deri më tani ua mori jetën 533 personave në Kosovë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", ARIANA MUSLIU-SHOSHI | FAQE 4-5



NIVELI I PËRFAQËSIMIT NË DIALOG LË PËR TË DËSHIRUAR

Deputetja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Ariana Musliu-Shoshi, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për organizimin e procesit të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se niveli i përfaqësimit të Kosovës për takimin e Uashingtonit lë për të dëshiruar. Sipas saj, delegacioni i Kosovës është i madh në numër dhe nuk e ka përvojën e duhur në bisedime për një çështje kaq të rëndësishme. Ajo ka thënë se pjesë e delegacionit shtetëror është dashur të jenë edhe ekspertët me përvojë politike dhe diplomatike

OPINION

UNIFORMA E UÇK-SË E KA PËRFUNDUAR MISIONIN E VET ME ÇLIRIMIN E KOSOVËS (42)

F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

PAPA BËN THIRRJE TË ANULOHEB BORXHI I VENDEVE TË VARFRA F. 2

HARADINAJ: AAK-ja ANGAZHOHEB PËR KOMUNA TË FORTA F. 5

NIS MËSIMI ONLINE NË MJEDISET SERBE NË KOSOVË F. 3

EKONOMI

DOGANA FILLON SHITJEN ONLINE TË MALLRAVE TË KONFISKUARA F. 8

SHBK: PAGUAJ ME KARTELË BANKARE, LUFTOJE EKONOMINË INFORMALE F. 8



Limaj: Diskutimi rreth çështjes së presidentit të ardhshëm, i hershëm



Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se çështja për postin e presidentit është diskutim i hershëm, pasi vendi ka president. "Kosova e ka presidentin aktual dhe çdo diskutim rreth kësaj teme tani është i hershëm, joetik dhe i panevojshëm", ka thënë Limaj. Duke folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, Limaj ka thënë se e çmon shumë rikthimin e ShBA-së në këtë proces | FAQE 7

Bizneset e sektorit privat diskutojnë për strategjinë e investimeve të Fondit Pensional

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Magedoni Xhepçisht - Tetovë Fax: +389 44 487 200
Curez-Ferizaj E-mail: renova@mt.net.mk Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT

RAHMANI DHE VOJVODA PARALAJMËROJNË FITORE NDAJ MOLDAVISË F. 18

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Papa bën thirrje të anulohet borxhi i vendeve të varfra

VATIKAN, 1 SHTATOR - Papa Françesku përsëriti thirrjen për anulimin e borxhit që kanë vendet e varfra. Ai ka thënë se për shkak të pandemisë është koha për "drejtësi rikuperuese". Papa po përgatitet për një audiencë me prani të publikut që do të mbahet të mërkurën. Kjo është audiencia e parë e

tillë që nga fillimi i pandemisë së koronavirusit në Itali, gjashtë muaj më parë, raporton AFP. "Unë përsëris thirrjen time për anulimin e borxhit të vendeve më të rrezikuara, si shenjë e njohjes së ndikimit të rëndë të krizës mjekësore, sociale dhe ekonomike që po përballen këto vende si pasojë e Covid-

19", ka pohuar kreu i Kishës Katolike.

Banka Botërore paralajmëroi muajin e kaluar se pandemia mund të ketë çuar deri në 100 milionë njerëz në varfëri ekstreme. Ekonomitë e zhvilluara tashmë janë zotuar të pezullojnë deri në fund të vitit pagesat e borxhit të vendeve më të varfra.



BE-ja: Mali i Zi duhet ta shfrytëzojë mundësinë për t'i përshpejtuar reformat

BRUKSEL, 1 SHTATOR - Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Joseph Borrell, dhe komisionari për Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, thanë se zgjedhjet në Mal të Zi janë mbajtur në atmosferë të qetë dhe konkurruese. Ata thanë se janë në pritje të konstituimit të kuvendit të ri dhe formimit të një qeverie të re që do ta vazhdojë rrugën e Malit të Zi drejt BE-së.

Në një deklaratë të përbashkët për zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi, që u mbajtën më 30 gusht, Borrell dhe Varhelyi thanë se në muajt e ardhshëm Mali i Zi duhet ta shfrytëzojë mundësinë për të thelluar dhe përshpejtuar reformat politike dhe ekonomike, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit.

Duke u thirrur në raportin paraprak të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR),

ata thanë se procesi zgjedhor është zhvilluar me një debat të polarizuar mbi çështjet e kishës dhe identitetit kombëtar dhe se ka pasur shqetësime për avantazhin e partisë në pushtet dhe raportimin e pabalancuar në media.

Borrell dhe Varhelyi kërkuar nga aktorët politikë dhe institucionet përkatëse që, pas raportit përfundimtar të ODIHR-it, të angazhohen në një dialog transparent, vendimtar dhe gjithëpërfshirës për zbatimin e rekomandimeve.

Dy zyrtarët e lartë evropianë konfirmuan se BE-ja është plotësisht e angazhuar për të vazhduar mbështetjen e procesit të pranimit të Malit të Zi në BE, si dhe për rimëkëmbjen e tij ekonomike pas pandemisë Covid-19.

Të dielën në Mal të Zi u mbajtën zgjedhjet parlamentare, në të cilat, për



herë të parë pas tri dekadash, Partia Demokratike e Socialistëve e presidentit Millo Gjukanoviq ka humbur. Zgjedhjet u fituan nga partitë

opozitare që konsiderohen si pro-serbe dhe pro-ruse. Mali i Zi, përndryshe, konsiderohet lider në procesin e integritimit evropian. Ai ka

qenë vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që ka nisur negociatat e pranimit me Bashkimin Evropian, në qershor të vitit 2012.

Gati 70 000 fëmijë 'në rrezik të vdesin' në Afrikën nën-Sahariane



LONDËR, 1 SHTATOR - Organizata britanike bamirëse "Save the Children" ka paralajmëruar se gati 70 000 fëmijë në Afrikën nën-Sahariane janë në rrezik të vdesin nga uria ekstreme, para fundit të këtij viti.

Organizata tha se pandemia Covid-19 i shtohet presionit që kanë disa familje dhe komunitete për të siguruar ushqim. "Save the Children" tha se është duke trajtuar një numër në rritje të fëmijëve që

vuajnë nga kequshqyerja, në klinikat e saj në Afrikën lindore dhe jugore.

Organizata tha se masat e bllokimit për shkak të koronavirusit, kanë bërë që familjet në kontinent të përballen me përkeqësim serioz të kushteve të jetesës dhe që ushqimi të bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u gjetur ose thjesht shumë i shtrenjtë.

Sipas analizës së saj, mbi 67 000 fëmijë mund të vdesin në vitin

2020.

Paralajmërimi pason një të ngjashëm nga Programi Botëror i Ushqimit i Kombeve të Bashkuara për rritjen e niveleve të urisë në të gjithë botën, për shkak të koronavirusit. Përpara pandemisë, komunitetet më së shumti në rrezik janë përballur me pasiguri ushqimore për shkak të përmbytjeve dhe zhvendosjeve në Afrikën lindore.

Sulm kibernetik ndaj parlamentit norvegjez

OSLO, 1 SHTATOR - Llogaritë e postës elektronike të disa ligjvënësve dhe punonjësve të Parlamentit të

Norvegjisë janë hakuar si pjesë e një sulmi kibernetik që ka ndodhur në ditët e fundit, raporton "Reuters".

"Në bazë të analizës sonë, sasi të ndryshme të të dhënave janë shkarkuar", ka njoftuar parlamenti në një

deklaratë, pa identifikuar deputetët apo stafin e prekur nga sulmi kibernetik.

Autoriteti Norvegjez i Sigurisë Kombëtare (NSA) ka ndihmuar për ta ndaluar sulmin.

Limaj: Diskutimi rreth çështjes së presidentit të ardhshëm, i hershëm



Serbisë”, është shprehur Limaj. Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se çështja për postin e presidentit është diskutim i hershëm, pasi vendi ka president. “Kosova e ka presidentin aktual dhe çdo diskutim rreth kësaj teme tani është i hershëm, joetik dhe i panevojshëm”, ka thënë Limaj.

Kosova ka nevojë për një qeverisje stabile me bazë të gjerë

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se Kosova ka nevojë për një qeverisje stabile me bazë të gjerë. “Unë jam gjithmonë për një qeverisje stabile me bazë të gjerë, sa më të fuqishme, duke ditur cilat janë sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi ynë. Forcat politike këtu janë për t’u shërbyer interesave nacionale, për të krijuar stabilitet dhe qeverisje efektive. Në situata ku vendi sfidohet dhe ka telashe të natyrave të ndryshme, partitë politike duhet të dalin mbi interesa të ngushta të tyre dhe të gjejnë rrugë që në këto sfida të punojnë duke forcuar institucionet, të qeveriset vendi dhe duke çuar mesazhin e gatishmërisë dhe pjekurisë politike për të avancuar edhe më tej konsolidim tonë shtetëror. Kështu që po, një qeverisje me bazë të gjerë është në shërbim të kësaj çka thashë”, ka thënë Limaj.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se çështja për postin e presidentit është diskutim i hershëm pasi vendi ka president. “Kosova e ka presidentin aktual dhe çdo diskutim rreth kësaj teme tani është i hershëm, joetik dhe i panevojshëm”, ka thënë Limaj. Duke folur për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, Limaj ka thënë se e çmon shumë rikthimin e ShBA-së në këtë proces

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Fatmir Limaj, kryetar i partisë Nisma Socialdemokrate, në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë” thotë se nga takimi në Uashington më 4 shtator në mes të përfaqësuesve të Kosovës dhe Serbisë, pritjet një rikthim i fuqishëm i dialogut i cili ka për qëllim njohjen përfundimtare reciproke mes dy vendeve.

Limaj, partia e të cilit është pjesë e Qeverisë aktuale në Kosovë, thekson se ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian do ta përshpejtojnë marrëveshjen e shumëpritur. Kurse për mospërfshirjen e opozitës në procesin e dialogut ai mendon se ‘opozita në instancën e fundit kurrë nuk mund të jetë kundër një marrëveshjeje të mirë e cila mbyll çështjet e hapura me Serbinë’. Limaj foli edhe për çështjen e presidentit të ri si dhe zgjerimin e koalicionit qeveritar. “Presim atë që ka qenë kërkesë e vazhdueshme tash e tri vjet nga

partnerët tanë më të fuqishëm, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian. Rikthim në dialog, rikthim i fuqishëm në dialog, i cili ka për qëllim njohjen përfundimtare reciproke mes dy vendeve dhe një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila mbyll të gjitha çështjet e hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë. Do të thotë, e presim dialogun për njohje reciproke”, ka thënë Limaj.

Ai ka thënë se pala e Kosovës në këtë proces ka qëndrim. “Ajo çfarë unë mund t’ju them është se ne e kemi qëndrimin si palë e Kosovës dhe se çka do të bisedohet në atë takim do të shihet. Por, jemi në dijeni dhe do ta mbajmë qëndrimin ne si palë e Kosovës me delegacionin atje, se qëndrimi është ky që e thashë. Siç e dini ju, duke u thirrur në letërën e presidentit Trump të para dy vjetëve, kur bën thirrje për rikthim në dialog të Kosovës dhe Serbisë, me letërën që ua ka dërguar dy

presidentëve, nuk duhet të humbet çasti historik që Kosova dhe Serbia në tavolinën e bisedimeve të vijnë deri te njohja reciproke. Këto thirrje janë edhe nga Bashkimi Evropian, sidomos nga kancelarja (gjermane) Angela Merkel dhe presidenti (francez) Macron që është konfirmuar edhe në samitin e fundit”, ka deklaruar Limaj.

Lideri i Nismës Socialdemokrate ka thënë se e çmon shumë rikthimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë proces. “Një gjë për ne është e qartë tash e sa vite, se pa pjesëmarrjen e ShBA-së dhe të BE-së dhe koordinimit mes tyre, në këtë pjesë të rajonit nuk ka pasur paqe dhe nuk janë arritur objektivat. Kosova ka argumente të mjaftueshme në tavolinën për të treguar atë që e thatë edhe ju, se ne kemi dëshmuar pjekuri dhe gatishmëri për të jetësuar balance të tilla në interesat

rajonale, sikur që kemi qenë jashtëzakonisht fleksibilë në ndërtimin brendapërbrenda shtetit tonë të sistemit juridiko-politik të Kosovës. Kështu që Kosova i ka të gjitha argumentet e mundshme. Tani vendi ynë, Kosova, ka bërë një gabim në qeverisjen e kaluar, duke mos marrë pjesë në dialog për arsye që dihen dhe të gjithë e kanë drejtuar gishtin nga Kosova si pengesë për arsye të taksës dhe reciprocitetit”, është shprehur Limaj, duke shtuar se tani Kosova kur të kthehet në dialog, duhet të demonstrojë pjekuri për ta arritur dialogun për të cilin jemi të ftuar, dialog për njohje. “Ne tani presim që partnerët të drejtohen nga zoti Vuçiq për të parë a e ka ai njëmend seriozisht për të ardhur te një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe reciproke, apo është duke bërë lojëra siç ka bërë politika serbe duke luajtur sa në Lindje sa në Perëndim dhe duke e zhargitur këtë proces mes Kosovës dhe

Nis mësimi online në mjediset serbe në Kosovë

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Institucionet arsimore në mjediset me shumicë serbe në Kosovë, të cilat veprojnë sipas sistemit të Serbisë, filluan ta martën mësimin online në përputhje me rekomandimet e Ministrisë së Arsimit të Serbisë.

Lubisha Karaxhiq, drejtor i Shkollës Filllore “Milladin Mitiq” në Llaple Sello, Komuna e Graçanicës, tha

për “Radion Evropa e Lirë” se kthimi i nxënësve në bankat shkollë është shtyrë për afat të pacaktuar për shkak të situatës epidemiologjike dhe bazuar në rekomandimin e Bordit të Shkollës nga Mitrovica e Veriut, që punon sipas sistemit të Republikës së Serbisë. “Nxënësit do ta kenë për detyrim të kthehen në shkollë kur situata rreth epidemisë të qetësohet dhe

kur të marrim një rekomandim të ri nga ministria [Qeveria e Serbisë]. Ne do të biem dakord vetëm me ta për praninë fizike të nxënësve në shkollë”, ka thënë Karaxhiq. Ministria e Arsimit e Kosovës e shtyu fillimin e vitit të ri shkollor deri më 14 shtator, në mënyrë që institucionet arsimore të përgatiten më mirë për kthimin e nxënësve në shkollë.



FLET PËR “EPOKËN E RE”, ARIANA MUSLIU-SHOSHI

NIVELI I PËRFAQËSIMIT NË D

Deputetja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Ariana Musliu-Shoshi, ka kritikuar Qeverinë e Kosovës për organizimin e procesit të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ajo ka thënë se niveli i përfaqësimit i Kosovës për takimin e Uashingtonit lë për të dëshiruar. Sipas saj, delegacioni i Kosovës është i madh në numër dhe nuk e ka përvojën e duhur në bisedime për një çështje kaq të rëndësishme. Ajo ka thënë se pjesë e delegacionit shtetëror është dashur të jenë edhe ekspertët me përvojë politike dhe diplomatike



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 1 shtator - Deputetja e Partisë Demokratike e Kosovës (PDK), Ariana Musliu-Shoshi, ka bërë me dije se niveli i përfaqësimit dhe organizimit të dialogut nga Qeveria e Kosovës lë për të dëshiruar. Ajo ka kritikuar delegacionin e Kosovës që ka udhëtuar për në Uashington për përbërjen dhe mungesën e përvojës në bisedime.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Musliu-Shoshi ka thënë se ftesa që qeveria ia ka bërë opozitës për këtë takim kanë qenë joserioze. “Niveli i përfaqësimit dhe organizimit të dialogut nga Qeveria e Kosovës lë për të dëshiruar. Jemi dëshmitarë që ftesat që na u janë bërë si opozitë, kanë qenë aspak serioze. PDK-ja ka kuptuar përmes portaleve se është ftuar për një takim në mënyrë që të bëhemi pjesë e delegacionit. Kryetari Veseli i është përgjigjur në mënyrë serioze duke thënë se ne do ta mbështesim dialogun në parim”, ka thënë Musliu-Shoshi.

Ajo ka vlerësuar se anëtarët e delegacionit të Kosovës do të duhej të ishin edhe ekspertë të ndryshëm me përvojë të madhe.

“Përbërja e delegacionit të Kosovës ishte e madhe dhe shpresoj se do të shërbejë për ta ndihmuar kryeministrin në vendimet që do të merren. Mendoj se delegacioni i Kosovës do të duhej të përfaqësohej edhe me ekspertë me përvojë politike dhe diplomatike. Kosova nuk ka kohë të humbë në çdo periudhë të dialogut e sidomos kur tani ky proces është duke u konsideruar përfundimtar”, është shprehur ajo.

Anëtarja e komisionit parlamentar për Punë të Jashtme ka rikonfirmuar edhe një herë se PDK-ja nuk do të bëhet pjesë e dialogut. “PDK-ja do ta ushtrojë rolin e saj kushtetues në procesin e dialogut si opozitë në Kuvendin e Kosovës, por nuk do të jetë pjesë e delegacionit. Për ne është e rëndësishme marrëveshja që do të sjellë për miratim në Kuvend, e cila për ne duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare që është në përputhje me platformën tashmë të njohur të saj, e cila garanton njohjen e ndërsjellë, sovranitetin shtetëror, integritetin territorial, karakterin unitar të shtetit dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB”, ka thënë ajo.

Musliu-Shoshi ka treguar se

komisioni për punë të jashtme nuk e ka pasur asnjë informacion për takimin e 4 shtatorit. “Si Komision për Punë të Jashtme ne i kemi mbajtur disa mbledhje, por në të cilat nuk kemi marrë as informacione sipërfaqësore për procesin e

dialogut. Kurse sa i përket takimit të 4 shtatorit, ne nuk e kemi asnjë informatë zyrtare, përveç atyre që janë thënë në portale dhe studio televizive. Kjo tregon joseriozitetin e kryeministrit si udhëheqës i këtij procesi”, ka deklaruar ajo.

“Epoka e re”: Znj. Musliu-Shoshi, delegacioni i Kosovës ka udhëtuar për në Uashington për takimin e 4 shtatorit. Çfarë mendoni për përbërjen e këtij delegacioni?

Musliu-Shoshi: Siç u raportua në media, sepse si deputete nuk

Haradinaj: AAK-ja angazhohet për komuna të forta

Prishtinë, 1 shtator (ER) - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur sot në takim kryetarin e kësaj partie në Kamenicë, njëherësh nënkryetar komune, Faton Jakupi, me bashkëpunëtorë. Haradinaj ka bërë me dije se në këtë takim diskutuan për procesin e dialogut në Shtëpinë e Bardhë dhe rëndësinë e takimit të 4 shtatorit për të ardhmen

e Kosovës. “Përderisa vendi ynë po kalon një periudhë të vështirë ekonomike, Faton Jakupi me bashkëpunëtorë, ka dhënë shembull të mirë pune, në dobi të qytetarëve të Kamenicës. I sigurova për mbështetjen time të plotë dhe inkurajova Fatonin e kolegët nga AAK-ja që, si pjesë e qeverisjes vendore, ta vazhdojnë punën dhe kontributin e tyre të shkëlqyer atje, për menax-

himin e pandemisë dhe mbështetjen e qytetarëve dhe bizneseve”, ka thënë Haradinaj pas takimit.

Ai ka theksuar se AAK-ja angazhohet për komuna të forta e me më shumë kompetenca. “Banorët dinë më së miri për çka kanë nevojë dhe janë më të aftë për menaxhimin e problemeve me të cilat ballafaqohen”, ka shkruar Haradinaj.



DIALOG LË PËR TË DËSHIRUAR

ekspertë me përvojë politike dhe diplomatike. Kosova nuk ka kohë të humbë në çdo periudhë të dialogut e sidomos kur tani ky proces është duke u konsideruar përfundimtar.

“Epoka e re”: Si Komision për Politikë të Jashtme, a keni diskutuar për këtë çështje dhe cili është qëndrimi i komisionit për këtë proces të rëndësishëm për Kosovën?

Musliu-Shoshi: Si Komision për Punë të Jashtme ne i kemi mbajtur disa mbledhje, në të cilat nuk kemi marrë as informacione sipërfaqësore për procesin e dialogut. Kurse sa i përket takimit të 4 shtatorit, ne nuk e kemi asnjë informatë zyrtare, përveç atyre që janë thënë në portale dhe studio televizive. Kjo tregon joseriozitetin e kryeministrit si udhëheqës i këtij procesi.

“Epoka e re”: Pjesë e takimit të Uashingtonit nuk do të jetë opozita. Çfarë do të thotë kjo për Kosovën?

Musliu-Shoshi: Përfshirja e ShBA-së në procesin e dialogut është një momentum i ri i cili duhet të shfrytëzohet nga Qeveria e Kosovës. Si Partia Demokratike e Kosovës e kemi thënë që ku është ShBA-ja jemi edhe ne. Edhe ShBA-ja edhe BE-ja janë partnerë strategjikë të shtetit tonë, sidoqoftë niveli i përfaqësimit dhe organizimit të dialogut nga Qeveria e Kosovës lë për të dëshiruar. Jemi dëshmitarë që ftesat që na u janë bërë si opozitë, kanë qenë aspak serioze. PDK-ja ka kuptuar përmes portaleve se është ftuar për një takim në mënyrë që të bëhemi pjesë e delegacionit. Kryetari Veseli i është përgjigjur në mënyrë serioze duke thënë se ne do ta mbështesim dialogun në parim. PDK-ja do ta ushtrojë rolin e saj kushtetues në procesin e dialogut, si opozitë në Kuvendin e Kosovës, por nuk do të jetë

pjesë e delegacionit. Për ne është e rëndësishme marrëveshja që do të sjellë për miratim në Kuvend, e cila për ne duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare që është në përputhje me platformën tashmë të njohur të saj, e cila garanton njohjen e ndërsjellë, sovranitetin shtetëror, integritetin territorial, karakterin unitar të shtetit dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB.

“Epoka e re”: Disa herë edhe partnerët e koalicionit qeverisës kanë shfaqur dallime për procesin e dialogut me Serbinë. A dëmtohet pozicioni i Kosovës në këtë proces në mungesë të një konsensusi nacional për këtë çështje?

Musliu-Shoshi: Me Serbinë në përballje kemi fituar vetëm kur kemi qenë të bashkuar. Por, koalicioni qeverisës gjatë tërë kohës ka shfaqur dallime të mëdha për procesin e dialogut

me Serbinë. Kjo medoemos e dëmton pozicionin e Kosovës në këtë proces për të cilin do të duhej të kishte konsensus nacional. E thashë edhe në pyetjen e sipërme, se për qeverinë do të duhej të dialogonte për marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare, e cila e garanton njohjen e ndërsjellë, që nuk e cenon sovranitetin shtetëror dhe që nuk e prek integritetin territorial. Përndryshe aspektet teknike që mund të sjellin përplasje të vazhdueshme në këtë proces nga partitë që e qeverisin vendin, do ta dëmtojnë Kosovën.

“Epoka e re”: A jeni informuar në ndonjë mënyrë si komision apo si deputete nga qeveria për takimin e 4 shtatorit në lidhje me atë se çfarë do të bisedohet atje?

Musliu-Shoshi: Përderisa unë jam duke iu përgjigjur gazetës

suaj, kryeministri me delegacionin e madh ka aterruar në Uashington DC, duke mos dhënë asnjë informacion të përgjithshëm e as të hollësishëm për anëtarët në Komisionin për Punë të Jashtme, e as për Kuvendin në veçanti si institucion që buron nga Kushtetuta dhe populli i Kosovës. Ai nuk gjeti kohë për të ardhur në seancë e të raportojë shkurtimisht për takimin që do të ndodhë.

Republika e Kosovës është demokraci parlamentare e përcaktuar me nenin 4 të Kushtetutës. Pikërisht për këtë arsye për ne si deputetë është i rëndësishëm informacioni për këtë takim, sepse cilido diskutim, cilado marrëveshje, në fund duhet ta marrë miratimin tonë. Por, të shohim e të presim takimin në mënyrë që kur të mbërrijë kryeministri në Kosovë, të vijë menjëherë në Kuvend e të raportojë.



jam e informuar, përbërja e delegacionit e Kosovës ishte e madhe dhe shpresoj se do të shërbejë për ta ndihmuar kryeministrin në vendimet që do të merren. Mendoj se delegacioni i Kosovës do të duhej të përfaqësohej edhe me

Veseli në Malishevë dhe Istog kërkon mobilizim të strukturave të PDK-së



MALISHEVË/ISTOG, 1 SHTATOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i shoqëruar nga anëtarë të Kryesisë Qendrore, ka takuar strukturat në Malishevë dhe Istog. Sfidat me të cilat po ballafaqohet vendi, sociale dhe politike, kanë qenë temë e diskutimit në këto takime. Kryetari Veseli, duke

përgëzuar këto dy degë për angazhimin, ka kërkuar mobilizim edhe më të madh në të mirë të qytetarëve. Kryetarët e degëve të Malishevës dhe të Istogut, Isni Kilaj dhe Lulzim Shoshi, kanë falënderuar kryetarin Veseli për mbështetjen e madhe dhe janë zotuar se interesat e qytetarëve dhe të shtetit do të jenë gjithmonë në rend të parë.

Let's Do It lanson fushatën 'Dita e Pastrimit të Botës, 19 shtator 2020'

Let's Do It ka ftuar individët, bizneset, institucionet që më 19 shtator t'i bashkohen Ditës së Pastrimit të Botës 2020 duke zhvilluar aksione për mbledhjen e filterëve të cigareve (apo edhe të mbeturinave të tjera) në lokacionet ku ata i vendosin vetë, duke respektuar masat e sigurisë në përputhje të situatës me pandeminë Covid-19



EPOKA ERE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 1 SHTATOR - "Nëse jemi të vëmendshëm ndaj ndotësve të ndryshëm të cilët u lihen natyrës, filterët e cigareve janë një prej llojeve më të shpeshta të mbeturinave të cilat mund t'i shohim të hedhur në rrugë, sheshe të qyteteve, parqeve e shpesh edhe në ekosisteme ujore. Ky lloj i mbeturinave, që fare pak mund të bie në sy të shumicës së njerëzve për shkak të madhësisë që ka, është jashtëzakonisht helmues dhe degradues për mjedisin. Një filtër i cigares përmban më shumë se 150 toksina të ndryshme të cilat mund të kontaminojnë deri në 1 000 litra ujë nëse atakojnë ekosistemet ujore. E në anën tjetër, nëse këto hidhen në vendet joadekuate duhen deri 15 vjet

për t'u shpërbërë për shkak të përbërjes plastike që kanë", është theksuar në njoftimin e Let's Do It.

Duke marrë parasysh faktin se sa i shpeshtë është "filtëri i cigares" si mbeturinë dhe ndikimin e lartpërmendur të këtij ndotësi në mjedis, si dhe në anën tjetër vetëdijen e ulët që shumica prej qytetarëve kanë në lidhje me këtë ndotës, Let's Do It ka vendosur që në fokus të Ditës së Pastrimit të Botës 2020 të jetë pikërisht largimi i sa më shumë filterëve të cigareve nga vendet joadekuate dhe rritja e vetëdijes së njerëzve për dëmet që ky ndotës i shkakton mjedisit.

Dita e Pastrimit të Botës në këtë vit do të shënohet më 19 shtator. Let's Do It, përveç fokusit në filterët e cigareve, do të vazhdojë që edhe më tutje të bëjë thirrje për komunat anembanë vendit që ta vazhdojnë eliminimin e

deponive ilegale të mbeturinave, sidomos ato të cilat janë krijuar gjatë periudhës së izolimit në pandemi. "Për shkak të masave të sigurisë, aktivitetet e fushatës këtë vit do të zhvillohen përmes ndërmarrjes së iniciativave në mënyrë individuale apo në grupe me numër të kufizuar të personave. Individët, bizneset, institucionet që duan të bëhen

pjesë e fushatës ftohen që gjatë aktivitetit të tyre të bëjnë ndonjë fotografi apo video dhe t'i postojnë ato nëpër rrjetet sociale, në mënyrë që ta sjellim sa më shumë vëmendjen e qytetarëve të filterët e cigareve si ndotës të rrezikshëm të mjedisit. Gjatë aksioneve për mbledhjen e filterëve të cigares, nuk do të thotë që mbeturina të tjera nuk mund të mblidhen", ka njoftuar

Let's Do It.

Let's Do It fton individët, bizneset, institucionet që më 19 shtator t'i bashkohen Ditës së Pastrimit të Botës 2020 duke zhvilluar aksione për mbledhjen e filterëve të cigareve (apo edhe të mbeturinave të tjera) në lokacionet ku ata i vendosin vetë, duke respektuar masat e sigurisë konform situatës me pandeminë Covid-19.

Infermierët kërkojnë shtesat prej 300 eurove



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës, Valbon Krasniqi, ka pritur në takim pune drejtuesit e Sindikatës së Infermierëve të

Kosovës. Në takim është biseduar në lidhje punën e infermierëve, me theks të veçantë angazhimin e infermierëve gjatë kohës së pandemisë së Covid-19. Po ashtu, u bisedua në lidhje me zbatimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për shtesat prej 300 eurove për

infermierët. Ai ka falënderuar sindikalistët dhe të gjithë infermierët për angazhimin e tyre të vazhdueshëm dhe punën profesionale që po bëjnë me pacientët në përgjithësi, e sidomos me trajtimin e rasteve me Covid.

Duke folur për zbatimin e vendimit të qeverisë për shtesat

në pagë, drejtori Krasniqi ka siguruar sindikalistët e infermierisë se zbatimi i vendimit do të bëhet në koordinim të plotë me Ministrinë e Shëndetësisë. Në anën tjetër, drejtuesit e Sindikatës së Infermierisë kanë falënderuar drejtorin për takimin dhe angazhimet e

vazhdueshme për të siguruar mirëqenie dhe kushte më të mira për infermierët.

Gjatë takimit drejtuesit e Sindikatës u pajtuan dhe u bindën se ekziston vullnet dhe angazhim konkret nga ShSKUK për tejkalim të situatës në lidhje me shtesat për muajin korrik dhe gusht për infermierët.

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Tetë të vdekur, 197 të shëruar dhe 147 raste të reja me Covid

Covid-19 deri më sot ua mori jetën 533 personave në Kosovë



Arben Hoti (RFE/RL)

Që nga fillimi i pandemisë në Kosovë kanë vdekur 533 njerëz si pasojë e infektimit me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit si pasojë e infektimit me Covid-19 kanë vdekur tetë persona, janë shëruar 197 dhe janë paraqitur 147 raste të reja të të infektuarve. Sipas IKShPK-së, në vendin tonë numri i rasteve aktive me koronavirus ka shkuar 3 276

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë ndërruar jetë tetë persona si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj kohe janë shëruar 197 persona dhe janë regjistruar 147 raste të reja me virusin "Korona". "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 534 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 147 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 8 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 13 601 raste nga 51 669 per-

sona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 533 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 197 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 9 792 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 276", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar edhe numrin e rasteve të reja sipas komunave në nivel vendi. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 38 raste, komuna Podujevë 19 raste, komuna Mitrovicë 14 raste, komuna Gjilan 9 raste, komuna Ferizaj 8 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Dragash 5 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Viti 5 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Skenderaj 4 raste, komuna Gjakovë 3 raste, komuna Kamenicë 3 raste, komuna Kaçanik 3 raste, komuna Malishevë 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Shtime

2 raste dhe me nga një rast komunat Hani i Elezit, Obiliq, Rahovec dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja në raportin 24-orësh.

Ndërsa Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) ka njoftuar të martën se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht në trajtim janë 432 pacientë. Prej tyre, 338 janë të infektuar me Covid-19. Në raportin ditor të ShSKUK-së është thënë se 8 pacientë janë në respiratorë, 27 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, kurse 293 të tjerë janë në oksigjenoterapi. Kosova ka gjithsej 700 shtretër në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në spitalet rajonale.

Zemaj aprovon kërkesën për importim të barnave kundër Covid-it pa autorizim të marketingut

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka aprovuar sot propozimin e grupit profesional të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Mjekësore (AKPPM) që për zbatimin e masave të veçanta, kjo agjenci të lëshojë licencë importi pa autorizim të marketingut për produktet për përdorim të pacientëve me Covid-19 si: "Remdesivir", "Favipiravir" dhe "Hydroxychloroquine". Ky aprovim vlen për periudhën gjatë pandemisë Covid-19 deri në

shfuqizimin e vendimeve të qeverisë për masa të veçanta, ka njoftuar MSh-ja. "Duke pasur parasysh situatën emergjente të krijuar si rrjedhojë e pandemisë së virusit Covid-19, grupi profesional i AKPPM-së, bazuar në nenin 39, paragrafi 1 i Ligjit nr. 04/L-190 për produkte dhe pajisje mjekësore, e ka parë të arsyeshme që të krijohet mundësia e importit të barnave 'Remdesivir', 'Favipiravir' dhe

'Hydroxychloroquine', me kushte të veçanta pa autorizim për marketing, në mënyrë që të shpejtohet qasja në këto barna të para para në udhërrëfyesin klinik nr. 9 mbi menaxhimin dhe trajtimin e Covid-19", ka njoftuar MSh-ja. Në këtë njoftim është thënë se Zemaj do ta autorizojë përfshirjen e këtyre tri barnave edhe në listën e esenciale të barnave përmes plotësim-ndryshimit të saj.

Ramadani: Kosova është e përgatitur të përballet me valën e dytë të Covid-19

Drejtori i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK), Naser Ramadani, ka thënë se Kosova është e përgatitur që të përballet me valën e re të pandemisë së koronavirusit. Pas vizitës në Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë, ai ka deklaruar se në dy javët e fundit ka rënie të lehtë të rasteve të reja me Covid. Sipas tij, kjo është një rënie premtuese nëse vazhdohet me respektimin e masave. "Si shtet jemi të përgatitur edhe për valën e dytë apo të tretë të Covid-19. Jemi të përgatitur në të gjitha aspektet menaxheriale, organizative, vendimmarrëse, politike, zbatuese, ekzekutive

e legislative që t'i dalim përballë valës së re eventuale që pritet të jetë në të gjithë botën prej tetorit e tutje", ka thënë Ramadani.

Ndërsa ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se në këtë shtëpi ka një përkushtim të stafit ndaj kujdesit të këtyre banorëve, përkundër kushteve jo edhe aq të mirë për ruajtje nga Covid-19. "Pamë një përkushtim të stafit mbi mbikëqyrjen. Angazhimi i stafit duhet të vlerësohet. Kushtet janë këto që janë", ka deklaruar ai. Gjatë kësaj vizite ai është informuar se aktualisht janë 13 persona të kësaj shtëpie të prekur nga koronavirusi.



Bizneset e sektorit privat diskutojnë për strategjinë e investimeve të Fondit Pensional

Drejtori Menaxhues i Fondit të Kursimeve Pensionale, Adrian Zalli, ka theksuar se ky fond momentalisht ka mjete në vlerë mbi dy miliardë euro. Sipas tij, mjetet e Fondit Pensional investohen me qëllim të rritjes së fitimit në investim vetëm në interes të pjesëmarrësve dhe të shfrytëzuesve, derisa parimet kryesore që duhet të ndiqen për realizimin e këtyre investimeve janë të përcaktuara me Ligjin për Fondin Pensional

për Bankën Qendrore të Kosovës, çdo aktivitet financiar duhet të licencohet nga ky institucion, gjë që derisa ruan konsumatorin, marrë parasysh faktin se njohuritë mbi financa janë të limituara, në të njëjtën kohë e kufizon inovacionin në sektorin e financave. Sa iu përket investimeve, Murati ka theksuar se sfidë mjaft e madhe është krijimi i lidhjeve mes individëve apo entiteteve me mjete për investim, me ata të cilët kanë nevojë për investime. Ai u shpreh se Fondi Pensional has në probleme për investime direkte në sektorin privat për shkak të pamundësisë për t'u marrë me raste të huadhënies individuale, vështirësisë për përcaktim të strukturës së investimit, si dhe parimit të vlerësimit të kthimit në investim.

Drejtori Menaxhues i Fondit të Kursimeve Pensionale, Adrian Zalli, ka theksuar se ky fond momentalisht ka mjete në vlerë mbi dy miliardë euro. Sipas tij, mjetet e Fondit Pensional investohen me qëllim të rritjes së

fitimit në investim vetëm në interes të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve, derisa parimet kryesore që duhet të ndiqen për realizimin e këtyre investimeve janë të përcaktuara me Ligjin për Fondin Pensional.

Zalli ka pohuar se këto parime duhet ta garantojnë sigurinë e fondit, shumëllojshmërinë e investimit, fitimin maksimal në përputhje me sigurinë e fondit si dhe mirëmbajtjen e likuiditetit adekuat. Ai ka potencuar se parim i bordit drejtues të këtij fondi është investimi i sa më shumë mjeteve në Kosovë përmes pjesëmarrjes në tregun e letrave me vlerë të cilat pastaj Qeveria e Republikës së Kosovës i investon aty ku është më e nevojshme. Sipas Zallit, Fondi Pensional aktualisht është në proces të krijimit të portofolave të veçanta për grupmoshat e ndryshme të tatimpaguesve, me anë të të cilave do të menaxhohet më lehtë risku i investimeve për kontributdhënësit.

Mërgim Cahani, kryeshef ekzekutiv në "Gjirafa", duke folur

për një periudhë dhjetëvjeçare, ka theksuar se tani kompanitë me vlerën më të madhe janë padyshim ato në sektorin e teknologjisë.

Cahani përmendi faktin se potenciali më i madh për zhvillimin ekonomik të vendit qëndron pikërisht në këtë sektor, prandaj i njëjti duhet të mbështetet më shumë përmes krijimit të mundësive për investime brenda shtetit. Cahani ka theksuar se mungesa e mundësive orienton kompanitë drejt investimeve të huaja të cilat shkaktojnë uljen e të hyrave për arken e shtetit, pasi që kthimi i investimeve të huaja nuk mbetet në qarkullim brenda Kosovës, por kthehet tek investuesi.

Valdrin Kasumaj, anëtar i bordit në Trustin Pensional të Kosovës, ka theksuar se kufizimet brenda mandatit ligjor të Fondit Pensional ndikojnë në mundësinë e këtij fondi për t'i përkrahur bizneset në Kosovë, derisa ka shtuar se gjatë vitit 2020 pjesëmarrja e Fondit në tregun e letrave me vlerë është rritur.

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka organizuar një forum virtual gjatë të cilit është diskutuar rreth strategjisë së investimeve të Fondit Pensional si dhe mundësitë që ofrohen për sektorin privat në Kosovë. Gjatë këtij forumi përfaqësuesit e bizneseve anëtare të Odës Ekonomike Amerikane patën mundësi të informoheshin rreth strukturës dhe kriterëve të kësaj strategjie.

Hekuran Murati, kryesues i

Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Transfere, ka theksuar se oferta për produkte financiare në Kosovë është paksa e kufizuar. Ai ka bërë me dije se për ndërmarrjet duhet të merren parasysh nevojat e investimit duke u bazuar në ciklin jetësor të tyre.

Sipas Muratit, për bizneset startup është rëndom më problem qasja në financa krahasuar me bizneset më të etabluara, të cilat mund të jenë më të parashikueshme për sektorin huadhënës.

Ai ka potencuar se për shkak të kufizimeve që rrjedhin nga Ligji

si vatra të vërteta të arsimit dhe të edukimit, me kontributin e atdhetarit Hasan Prishtina dhe me shumë të tjerë. Filatelia e Postës së Kosovës do të angazhohet që përmes imazheve të pullave postare t'i afirmojë vlerat tona kulturore, arsimore dhe kombëtare.

Del në qarkullim pulla postare "Shkolla e parë shqipe në Stubëll"

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Posta e Kosovës nga dita e martë ka vënë në qarkullim emisionin e pullës postare "Shkolla e parë shqipe në Stubëll".

Imazhi që bartë kjo pullë postare i dedikohet vatrës së parë të diturisë në Kosovë, e

njohur si Kolegji i Shën Llukës, në fshatin Stubëll të Vitisë në vitin 1584.

Shkollat shqipe në Kosovë zhvillohen dhe përforcohen gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si në Prizren, Pejë, Gjakovë, Zym, Janjevë dhe Stubëll, pranë Kishave Katolike,



ShBK: Paguaj me kartelë bankare, luftoje ekonominë informale

Shoqata e Bankave e Kosovës (ShBK) u ka bërë thirrje konsumatorëve që t'i përdorin kartelat bankare me rastin e pagesës dhe rrjedhimisht ta shmangin pagesën me kesh. "Pagesat me kartelë bankare reduktojnë përdorimin e keshit. Kjo ndihmon në luftimin e ekonomisë joformale dhe parasë së falsifikuar", theksohet në njoftimin e ShBK-së

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Shoqata e Bankave e Kosovës (ShBK) në bashkëpunim me "Visa" kanë lansuar fushatën informuese për rritjen e pagesave me kartela bankare në Kosovë dhe për reduktimin e parasë kesh në ekonomi. "Sektori bankar në Kosovë ka arritur që të ndërtojë një infrastrukturë mjaft të gjerë

të pagesave e cila shtrihet në tërë Kosovën. Në këtë infrastrukturë bëjnë pjesë edhe pikat e shitjeve POS ku blerësit mund t'i bëjnë pagesat e tyre me kartela bankare. Duke pasur parasysh që përdorimi i kartelave bankare konsiderohet një prej mundësive më të shpejta dhe më të sigurta për t'i kryer pagesat, edhe sektori bankar në Kosovë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë. Në

këtë drejtim Shoqata e Bankave e Kosovës, me mbështetje nga bankat komerciale të Kosovës dhe 'Visa', ka lansuar një fushatë informuese për të sqaruar se cilat janë përfitimet e qytetarëve nëse kryejnë pagesat e tyre me kartelë bankare", thuhet në njoftimin e ShBK-së.

Sipas kësaj shoqate, kjo fushatë ka për qëllim ta rrisë besimin në përdorimin e kartelave bankare dhe të ndikojë pozitivisht te rritja e pagesave me kartela bankare në Kosovë dhe reduktimin e parasë kesh në ekonomi. "Reduktimi i përdorimit të parasë së gatshme dhe rritja e pagesave elektronike do të kontribuonte edhe në luftimin e ekonomisë informale e cila shpesh përcillet me transaksione me KESH, por edhe do ta rriste

konkurrencën në fushën e pagesave e që sjell përfitime të shumta për konsumatorët, po ashtu edhe për bizneset si dhe ekonominë në tërësi", thuhet në njoftimin e ShBK-së.

Përfitimet janë të shumta: Kartela bankare ofron siguri dhe lehtësi në pagesa duke mundësuar edhe transaksionet pa kontakt për shumica të vogla dhe të përditshme. Në këtë kohë pandemie kjo mundësi për të paguar pa kontakt ndikon edhe në parandalimin e shpërndarjes së virusit Covid-19; Pagesa me kartelë bankare kursen kohën pasi që nuk keni nevojë që çdoherë të bëni tërheqje të parasë kesh në bankomat dhe të mbani kesh me vete, gjithashtu me kartelë bankare mund të bëni blerje dhe pagesa online, kështu duke kursyer kohën tuaj; Pagesat me

kartelë bankare regjistrohen në raportin tuaj bankar duke mundësuar menaxhimin më të mirë të shpenzimeve dhe financave personale; Pagesat me kartelë bankare reduktojnë përdorimin e keshit. Kjo ndihmon në luftimin e ekonomisë joformale dhe të parasë së falsifikuar; Dhe pagesat me kartelë bankare mund të bëhen në të gjitha pajisjet POS të bankave të Kosovës, pa asnjë kosto shtesë dhe pa dallim në shumën që e paguani, kostoja e transaksionit për kartelëmbajtësit është zero.

Fushata do të zhvillohet gjatë muajve shtator - nëntor 2020 dhe pritet të ketë ndikim pozitiv për klientët bankarë, për avancimin e tregut të pagesave si dhe për ekonominë e Kosovës në tërësi.



Dogana fillon shitjen online të mallrave të konfiskuara

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Nga dita e martë Dogana e Kosovës ka funksionalizuar sistemin e shitjeve online për mallra të konfiskuara. Në kuadër të modernizimit dhe përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, Dogana ka filluar sistemin më të ri të shitjeve online. Ky sistem u mundëson të gjithë qytetarëve të Republikës se

Kosovës që të kenë qasje dhe të marrin pjesë online në ankandet e organizuara nga Dogana. Sistemi funksionon përmes uebfaqes, ku fillimisht kërkohet regjistrimi e pastaj qasja në ankandë është automatike. "Pas sistemit të zhdoganimeve Asycuda, sistemin e komunikimit online, e-administratës tani sistemi i shitjeve

online të mallrave të konfiskuara ka shndërruar Doganën e Kosovës në administratën e parë në vend që funksionon 100 për qind online dhe u mundëson të gjitha palëve të interesit të kenë qasje dhe përdorim të shërbimeve të doganës në mënyrë elektronike", thuhet në njoftimin e Doganës së Kosovës.



Ismajli: Covid-19 është virus që na thërret të gjithëve për kujdes të lartë

GJILAN, 1 SHTATOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, në takimin e mbajtur të martën me Komitetin e Emergjencave, për parandalimin e pandemisë globale Covid-19, ka kërkuar angazhimin maksimal për respektimin e rekomandimeve të qeverisë, njëkohësisht ka falënderuar qytetarët e Gjilanit për lojalitetin e vazhdueshëm. Ai ka potencuar se duke u bazuar në konstatimet e ekspertëve në nivel vendi, reziku nga pandemia Covid-19 është i lartë, prandaj ka ftuar përgjegjësit e institucioneve që të ketë kujdes maksimal me stafin, gjithashtu nga sektori

privat dhe qytetarët, që t'i respektojnë masat mbrojtëse konform rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë dhe të mjekëve. "Gjendja e përgjithshme në Gjilan është e qetë dhe nën kontroll të vazhdueshëm falë angazhimit të stafit mjekësor në dy nivelet primare dhe sekondare, pastaj angazhimit të vazhdueshëm të Policisë së Kosovës dhe lojalitetit qytetar në përgjithësi, duke përfshirë edhe sektorin e biznesit privat që po zbatojnë rekomandimet e shtetit. Vetëdijesimi në Gjilan tashmë është bërë pjesë e të jetuarit dhe masat mbrojtëse në një përqindje të lartë janë

duke u respektuar", ka thënë nënkryetari Ismajli. Më tej, Ismajli ka ndarë dhembjen me të gjithë familjet gjilanasë që në këtë kohë pandemie kanë humbur më të dashurit e tyre për shkak të virusit, i cili është një kërcënues serioz por, siç ka thënë ai, duhet t'i bëjmë ballë. "Në asnjë moment nuk i harrojmë familjet gjilanasë që kanë humbur më të dashurit e tyre. Me të gjitha ndajmë dhimbjen dhe do të jemi pranë tyre vazhdimisht. Të infektuarit që janë duke luftuar me virusin, janë pjesë e jona dhe urojmë që sa më parë ta kalojnë këtë sfidë", ka thënë



nënkryetari Ismajli. Deri më tani nga statistikat e përgjithshme Gjilani ka 844 të infektuar, prej tyre 648 janë të shëruar plotësisht, 163 janë raste aktive, 33 të vdekur, ndërsa të hospitalizuar janë 49

pacientë, derisa mostra në pritje janë 19. Apeli i përbashkët është kujdesi maksimal, ruajtja e distancës dhe përdorimi i maskave, dezinfektuesve dhe mosgrumbullimi.

Jasharaj dhe Shala bisedojnë për përgatitjet e fillimit të vitit të ri shkollor në kryeqytet

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar i Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), Rrahman Jasharaj, bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, janë takuar në ambientet e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) të Prishtinës me drejtoreshën Shpresa Shala. Temë kyçe e bisedës në këtë takim ishte rrjedha e përgatitjeve që janë dhe po bëhen në institucionet arsimore të kësaj komune për nisjen e vitit shkollor më 14 shtator. Drejtoresha Shala është shprehur e kënaqur me bashkëpunimin korrekt me SBASHK-un dhe ka treguar për angazhimet e shumta që janë bërë gjatë gjithë verës për përgatitjen e udhëzimeve konkrete në institucionet arsimore. Ajo ka vlerësuar se falë përkushtimit të DKA-së, drejtorëve dhe stafit dhe gjithë të punësuarve në shkolla e



institucione të tjera janë bërë përgatitje të nivelit më të lartë të mundshëm dhe se 14 shtatori do t'i gjejë me fillim të mbarë të vitit të ri shkollor. Ndërsa përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë përgëzuar drejtoreshën Shala për angazhimet dhe arritjet. Ata kanë falënderuar Shalën për bashkëpunimin korrekt me SBASHK-un në përpjekjet e përbashkëta në shërbim të arsimit. Jasharaj dhe Ymeri i janë drejtuar drejtoreshës Shala me

lutjen që mësimdhënësit e kësaj komune të lirohen gjatë këtij viti shkollor nga obligimi i shënimit të orëve mësimore në ditarët elektronikë, duke i shënuar ato në ditarët klasikë. Drejtoresha Shala ka aprovuar kërkesën e SBASHK-ut që sot (e mërkurë) ajo me përfaqësues të kësaj sindikate të vizitojnë ndonjë nga institucionet arsimore për t'i parë nga afër përgatitjet dhe angazhimet që janë duke u bërë me qëllim të përgatitjes për fillimin e vitit të ri shkollor.

Deçani i jep mbështetje iniciativës për ngritjen e memorialit për vëllezërit Bytyqi

Deçan, 1 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se bordi i drejtorëve i kësaj komune i ka dhënë mbështetje iniciativës së deputetit Daut Haradinaj për ngritjen e memorialit kushtuar vëllezërve Bytyqi. Ramosaj ka thënë se kjo komunë do të kontribuojë edhe financiarisht për ndërtimin e këtij memoriali. "Në takimin e mbajtur sot me bordin e drejtorëve, përveç mbështetjes së iniciativës të deputetit Daut Haradinaj, për ngritjen e memorialit kushtuar vëllezërve

Bytyqi, Komuna e Deçanit shpreh gatishmërinë të participojë edhe financiarisht brenda mundësive të veta. Lavdi e përjetshme!", ka njoftuar Ramosaj. Vëllezërit Agron (23), Mehmet (21) dhe Ylli Bytyqi (25) si qytetarë amerikanë gjatë luftës në Kosovë kishin vendosur t'i bashkoheshin UÇK-së në kuadër të Batalionit "Atlantiku". Ata ishin vrarë në Serbi pas përfundimit të luftës çlirimtare (1999). Që nga ajo kohë askush nuk është dënuar në lidhje me vrasjen e vëllezërve Bytyqi.



Filloi rregullimi i dhjetë rrugëve në Shkozë dhe i një rrugë në Maxharrë të Malishevës

PRISHTINË, 1 SHTATOR (ER) - Ka filluar hapja dhe rregullimi i dhjetë rrugëve në fshatin Shkozë dhe i një rrugë në fshatin Maxharrë i Komunës së Malishevës. Punimet në këto rrugë i ka parë nga afër drejtori i Urbanizimit, Ahmet Morina, i cili është takuar edhe me përgjegjësit e këtyre dy fshatrave. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi nga afër për punimet në rrugët që janë duke u rregulluar dhe informimi nga kryetarët e

fshatrave Shkozë, Luan Bytyqi dhe Maxharrë nga Muhamet Kastrati, nëse ata kanë vërejtje për ecurinë e punimeve. "Sot vizitova këto dy fshatra, në të cilët janë duke u rregulluar njëmbëdhjetë rrugë, me qëllim të informimit me ecurinë e punimeve dhe zbatimin e planit dinamik për realizimin e këtyre projekteve, pasi kemi të bëjmë një numër të madh të rrugëve që janë duke u rregulluar", ka thënë drejtori Morina, duke shtuar se të gjitha këto rrugë në Shkozë

dhe Maxharrë, po ashtu edhe në fshatrat e tjera ku është duke u punuar pa ndërprerë, janë pjesë e investimeve kapitale në infrastrukturën rrugore në të gjitha vendbanimet e Komunës së Malishevës të cilat kanë qenë pjesë e listës së investimeve kapitale të miratuar në Asambleenë Komunale. "Të gjitha këto rrugë financohen nga buxheti i Komunës së Malishevës", ka deklaruar drejtori i Drejtorisë së Urbanizimit, Ahmet Morina.



UNIFORMA E UÇK-së E KA PËRFUNDUAR MISIONIN E VET ME ÇLIRIMIN E KOSOVËS (42)



Shkruan: Kudusi LAMA

Për pikat e raportit në fjalë, prej 134 e deri në pikën 166, nuk marrë përgjegjësi për të bërë komente, pasi i përket një terreni që është jashtë zonës time të përgjegjësisë dhe i përket kohës pas përfundimit të luftës çlirimtare të Kosovës. Por në këtë pjesë të raportit më tërheq vëmendjen fakti që ju zotëri Marty për çdo veprim që kryhet futni inicialet UÇK-së dhe flisni për luftëtarë dhe simpatizantë të UÇK-së, duke ia veshur aktet e kriminalitetit uniformës së UÇK-së.

Unë kam arsyetuar dhe do të arsyetoj, për këto çështje, duke dhënë mendimin tim edhe për këtë periudhë, por realisht ju nuk keni pse i vishni kriminelët me uniformën e UÇK-së edhe nëse këto krime do të jenë të vërteta dhe kriminelët do të kenë vepruar. Uniforma e UÇK-së e ka përfunduar misionin e vet me çlirimin e Kosovës. Nëse dikush mund të ketë qenë kriminel para kësaj lufte apo të jetë bërë kriminel pas saj, nuk keni asnjë të drejtë që të kriminalizoni gjithë atë uniformë të lavdisë shqiptare. Prandaj, ju duhet ta ndani luftën nga paslufta. Ishte fati i luftëtarëve që nuk u vranë të gjithë në frontet e luftës. Nuk keni asnjë të drejtë t'i përgojoni ata. Përgjegjësi e krimit pas lufte nëse ka ekzistuar apo ekziston nuk ka uniformën e ushtrisë së lirisë, por të ushtrisë së robërisë, e ajo zotëri nuk është uniforma e UÇK-së. Megjithatë unë ju mirëkuptoj, sepse në shpirtin dhe zemrën tuaj ka aq urrejtje ndaj shqiptarëve sa, po të kishit mundësi, çdo shqiptar do ta etiketonit kriminel dhe do ta kërkoni dënimin kapital për të. Por, ja që nuk keni mundësi e prandaj edhe villni vrer pa ndërprerë, duke goditur pikërisht në pikën më delikate shqiptare, në simbolin e krenarisë kombëtare, në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Më poshtë, siç duket, ju e ndieni dështimin zotëri Marty dhe dështimi duket në pikën 171, ku ju thoni: "... me sa duket, autorët e këtyre akteve

do të parapëlqenin të dilnin para drejtësisë për rolin që mendohet se kanë luajtur përkatësisht në administrimin e kampeve të burgimit dhe në trafikimin e organeve njerëzore, sesa të kompromentonin ish komandantët e lartë të UÇK-së nën urdhrat e të cilëve ata do kenë vepruar dhe që sot janë bërë drejtues politikë e ekonomikë". Keni deklaruar një rrugëdalje prej dështimit. Në qoftë se nuk del gjë - thoni ju në nënkuptim - nuk e kam fajin unë që kam shpifur, por e kanë shqiptarët që më mirë pranojnë të bëjnë burgje vetë se sa të shpifin e të ngarkojnë të tjerët siç po bëj unë për interesat e serbëve. Kështu zotëri Marty? Prapë shqiptarët ua kanë fajin? Sa keqe për ju zotëri, që në fund tregoni vetë pasaktësinë e asaj që keni shkruar më lartë.

Po zotëri, shqiptarët nuk janë shpifës të ndyrë, por njerëz vital, që nuk mashtrohen nga shpërblimet tuaja. Ata ndoshta edhe mund të bëjnë burgje, por të jeni i sigurt, për periudhën e Luftës Çlirimtare të Kosovës, nëse luftëtarët do të bëjnë burgje, i vetmi fajtor jeni ju, që

keni shpifur për ta dhe që tani kërkoni që ata të shpifin për udhëheqësit e tyre në qoftë se duan të shpëtojnë lëkurën e tyre.

Zotëri, shqiptarët nuk e matin personalitetin me kilogramët e mishit që kanë në trupin e tyre, por me forcën e karakterit dhe qëndrueshmërisë para të keqes.

Shqiptarët i nderojnë edhe udhëheqësit e tyre, por i duan dhe i nderojnë për ndershmërinë dhe forcën e tyre e jo për krimet, siç imagjinoni e deklaroni ju.

Dhe ndershmërinë dhe besnikërinë ne nuk e kemi ndaj klaneve, sepse të tillët nuk ekzistojnë tek ne, por ndaj vetvetes. Shqiptarët e nderojnë shumë veten e tyre, ndaj nuk mund ta përbaltin pse do një Dick Marty, me çfarëdo funksioni qoftë ai. Klanet kanë lindur atje tek ju dhe ne kemi mësuar për ekzistencën dhe funksionalitetin e tyre duke njohur historinë tuaj atje në Evropë. Te shqiptarët zotëri nuk ka "kumbarë të llumit" por udhëheqës të luftës për çlirimin e vendit nga pushtuesi. Ne nuk lejojmë të na vihen të tjerët mbi kokë, qofshin ata edhe

shqiptarë në shërbimin tuaj. Ju ose nuk e njihni karakterin e shqiptarëve, ose doni të bëni ashtu si bëni për t'i nëpërkëmbur ata, por nuk ka asgjë të vërtetë në ato që thoni ju në karakterin e shqiptarëve, prandaj është më e arsyeshme ta fshish atë pikën 172 të raportit.

Ndërsa në pikën 174, duke vënë në evidencë mospranimin e shqiptarëve për t'u bërë pjesë me ju e raportin tuaj, nxirrni një sekret, kur shpreheni: "E gjithë kjo ka për qëllim që t'u bëjë të mundur disa udhëheqësve politikë të shmangin në mënyrë të besueshme pohimet sipas të cilave UÇK-ja do ketë marrë pjesë në akte burgimi, torture dhe vrasje në Shqipëri, dhe t'i paraqesë si një "spektakël" i thjeshtë, orkestruar nga propaganda politike serbe, thënie serioze që meritojnë, siç e pamë, hetime shumë më të thella se ato që janë bërë gjë më sot". Pra ju e dini se këto do të kuptohet se nuk janë tjetër vetëm "një spektakël" i thjeshtë, orkestruar nga propaganda politike serbe". Për këtë më vjen mirë. Ju në fund tregoni se cili do të jetë fati i raportit tuaj. Pra ju e dini të vërtetën zotëri Marty.

Sa turp për ju që shpifni dhe kërkoni t'i mbushni mendjen vetes duke u shprehur: "... Ne nuk u bëmë përhapës fjalësh të thjeshta lart e poshtë, por përshkruam fakte që mbështeten në dëshmi të shumta, në dokumente dhe fakte objektive". Po zotëri Marty, bindeni veten se nuk jeni bërë një përhapës fjalësh, por në fakt ti e ke bindur të paktën gjithë kombin shqiptar që nuk je tjetër veçse një përhapës fjalësh.

Në gjithë rrjedhën e raportit të kësaj fjalologjie, ju thirrreni në emër të nxjerrjes në dritë të të vërtetës, por e vërteta duket se për ju është ajo që ju keni dëshirë të vërtetohet. Me keqardhje mund t'iu them se atë të vërtetë që kërkoni, duke pretenduar se shqiptarët mund t'i largojë nga kriminaliteti vetëm arma dhe shkopi i policit serb, që e keni shprehur në mënyra të ndryshme gjatë raportit, nuk do të mund ta përjetoni kurrë. Shqiptarët nuk do të jenë më kurrë nën pushtimin e Serbisë. Të jeni i sigurt, mund të flisni si të doni e sa të doni, por nga pushtimi serb do të çlirohen edhe ato treva që akoma kanë mbetur të pushtuara. (Fund)



Si u bë Mesdheu Lindor, 'syri' i një 'cikloni' gjeopolitik?

Nga Michael TANCHUM

Në mesin e muajit gusht, luftanijet turke dhe greke "shkëmbyen xixa" mes tyre në Mesdheun Lindor, duke rritur tensionet mes dy vendeve në nivelin më të lartë të 20 viteve të fundit. Kriza kishte nisur disa ditë më parë, kur Turqia dërgoi një anije shpimi, të shoqëruar nga luftanijet turke, për të kërkuar naftë dhe gaz natyror në ujërat pranë ishullit grek Kastelorizo, të cilin Athina e pretendon si territorin e saj detar. Më shumë se kurrë më parë, ngjarjet e fundit rrezikojnë të përshkallëzohen në një konflikt shumëkombësh. Në një shfaqje të mbështetjes së vendosur ndaj Greqisë dhe kundër Turqisë, Franca dërgoi luftanijet veta në ujërat e kontestuara.

Egjipti dhe Izraeli, që zhvillojnë stërvitje të rregullta ushtarake me Greqinë, kanë shprehur gjithashtu solidaritetin e tyre me Athinën. Me Francën dhe Egjiptin që janë tashmë në një konflikt të hapur me Turqinë në Libi, vëzhguesit në mbarë botën druhen se çdo përshkallëzim i mëtejshëm i tensioneve në Mesdheun Lindor, mund të degradojë në një krizë të madhe nga Evropa në Lindjen e Mesme. Po si u bë Mesdheu Lindor "syri" i një "cikloni" gjeopolitik? Për dekada me radhë, mosmarrëveshjet mbi kufirin detar në Mesdhe, kanë qenë çështje lokale, dhe të kufizuara tek pretendimet e sovranitetit, dhe deklaratat dhe kundër-deklaratat midis Qipros, Greqisë dhe Turqisë.

Por, gjatë 5 viteve të fundit, burimet e mëdha në det të hapur të gazit natyror, e kanë shndërruar Mesdheun Lindor në një arenë kryesore strategjike, ku konvergojnë vijat ndarëse më të mëdha gjeopolitike, që përfshijnë Bashkimin Evropian, dhe rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut.

Italia dhe Franca, kanë luajtur një rol kryesor në nxitjen e këtij ndryshimi, që i ka tendosur edhe më tej marrëdhëniet tashmë të ndërlikuara BE-Turqi. Gjërat nisën të ndryshojnë pas zbulimit në gushtin e vitit 2015 të fushës së madhe të gazit natyror në Zohr, terror detar egjiptian nga ana gjigantit energjetik italian ENI.

Zbulimi i rezervës më të madhe me gaz natyror në Mesdheun Lindor deri më sot, nënkuptonte që rajoni kishte befaz një rëndësi të madhe. ENI, që është gjithashtu operatori kryesor në shpimet që po kryen rrotull ishullit të Qipros, nisi të promovojë një plan për të grumbulluar gazin qipriot, egjiptian dhe atë izraelit, dhe të përdorë gazsjellësit në Egjipt për



ta sjellë gazin në Evropë me një kosto të arsyeshme.

Por projekti mënjantonte Turqinë dhe infrastrukturën e saj të gazsjellësave, duke u përplasur kështu me planet e Ankarasë për t'u shndërruar në një fuqi energjetike rajonale. Në vitin 2018, gjiganti energjetik francez "Total", kompania e tretë më e madhe e BE-së sa i përket të ardhurave, i dha një goditje tjetër Turqisë duke hyrë në një partneritet me ENI-in në të gjitha operacionet e kërkimit të gazit në Qipro.

Ky veprim e vendosi Francën në mesin e rezervave më të mëdha energjetike të Mesdheut Lindor. Ndërkohë, Qipro ra zyrtarisht dakord të shfrytëzojë infrastrukturën e Egjiptit për eksportin e gazit. Pasi lëvizjes se Nikozias, Izraeli, që më parë kishte menduar të ndërtonte një gazsjellës nën ujë Izrael-Turqi, u tërhoq nga projekti, dhe nënshkroi një kontratë për t'ia shitur gazin e vet Egjiptit.

Turqia e shprehu pakënaqësinë e saj për këto zhvillime, duke u angazhuar në një seri lëvizjesh diplomatike, duke kryer eksplorime dhe shpime në ujërat qipriote, secila e shoqëruar nga luftanijet turke. Ankaraja vazhdon të refuzojë njohjen e kufijve detarë të Qipros, të cilat Turqia mendon se u hartuan në mënyrë të paligjshme në dëm të saj.

Në këtë mënyrë, ajo pretendon se po mbron të drejtat e turqve qipriotë në gjysmën veriore të ishullit, të cilët kanë mbetur jashtë zhvillimit të rezervave të gazit natyror të Qipros, pavarësisht se janë bashkëpronarët e ligjshëm të burimeve natyrore të ishullit të ndarë.

Pas çdo veprimi të Turqisë, fronti Egjipt-Izrael-Qipro-Greqi fitoi gjithnjë e më shumë mbështetje ushtarake nga Franca, Italia dhe Shtetet e Bashkuara, ku secila ka investime të rëndësishme ekonomike mbi gazin e

Mesdheut Lindor.

Për Turqinë, mbështetja e aleatëve të saj të NATO-s ndaj këtij grupimi është një tradhti, të cilën ajo nuk mund ta tolerojë. Në një përpjekje për të dalë nga izolimi i saj rajonal, Turqia nënshkroi në nëntorin e 2019-ës marrëveshjen e saj të kufirit detar me Qeverinë e Akordit Kombëtar (GNA) me qendër në Tripoli në Libinë e shkatërruar nga lufta. Marrëveshja ishte një përpjekje për të pasur pozita më të forta ligjore, për të sfiduar kufijtë detarë që Greqia ka hartuar me Qipron dhe Egjiptin, dhe nga të cilat varen planet e tyre në Mesdheun Lindor për nxjerrjen e gazit natyror.

Marrëveshja Ankara-Tripoli u shoqërua me një pakt të bashkëpunimit ushtarak, që i siguroi GNA-së ndihmë kundër përpjekjeve të forcave të gjeneralit Kalifa Haftar, të mbështetur nga Franca dhe Egjipti, për të rrëzuar qeverinë me seli në Tripoli. GNA e aktivizoi zyrtarisht paktin e saj ushtarak me Ankarën në dhjetorin e vitit të shkuar.

Dhe ndërhyrja e hapur e Ankarasë në konfliktin libian, i jep Ankarasë një platformë prej nga ku ajo mund të sfidojë Qipron, Egjiptin dhe Greqinë mbi kufijtë detarë të Mesdheut Lindor. Duke përfutur nga pozicioni i saj rajonal i sapo-përmirësuar, Turqia u përpoq të promovonte pretendimet e saj ndaj Greqisë, duke dërguar anijen e saj të shpimeve "Oruç Reis", të shoqëruar nga 5 luftanije turke në ujërat e kontestuara pranë Kastelorizo.

Turqia i konsideron veprimet e saj si të bazuara në të drejtën ndërkombëtare. Dhe Ankaraja ka pjesërisht të drejtë, kur pretendon se kufiri detar me Greqinë është i padrejta. Vija bregdetare mesdhetare e Turqisë, është më e gjatë se kufiri SHBA-Meksikë.

Dhe sipas Konventës së Ligjit të Detit të Kombeve të Bashkuara

(UNCLOS), Turqia ka të ngjarë të ketë të drejtë një zonë detare më të madhe nga sa ka aktualisht. Por nga ana tjetër, Turqia nuk pranon të nënshkruajë UNCLOS, çka ia mbyll rrugën çdo lloj rekursi juridik mbi këtë çështje.

Ndërkohë harta e marrëveshjes së kufirit detar Turqi-Libi, përcakton një zonë detare maksimale për Turqinë, duke i mohuar secilit prej ishujve grekë një shelf kontinental ose një Zonë Ekskluzive Ekonomike (EEZ), që siguron të drejtat sovraane mbi burimet energjetike në det të hapur.

Më 6 gusht, Greqia iu përgjigj Turqisë me të njëjtën monedhë, duke nënshkruar një marrëveshje të ngjashme të kufirit detar me Egjiptin. Disa ditë më vonë, anija kërkimore "Oruç Reis" depërtoi brenda kufijve detarë të Greqisë. Po çfarë pritet të ndodhë më tej? Shumica e palëve në rajon kanë shumë arsye, që të angazhohen në uljen e tensioneve, dhe të gjejnë një zgjidhje të shpejtë të krizës. Pavarësisht se e mbështesin Greqinë, as Egjipti dhe as Izraeli nuk mund t'i lejojnë vetes të zhyten në një luftë me Turqinë në Mesdheun Lindor.

BE-ja e ka shprehur mbështetjen e saj të paanshme për anëtarët e unionit, Greqinë dhe Qipron. Por blloku është i përçarë mbi mënyrën se si duhet trajtuar kriza aktuale. Gjashtë vendet mesdhetare të BE-së, janë të ndara në mënyrë të barabartë. Greqia, Qipro dhe Franca mbrojnë një veprim të fortë kundër Turqisë, ndërsa Italia, Malta dhe Spanja – që kanë interesa të mëdha tregtare me Turqinë në Mesdheun Qendror dhe atë Perëndimor – e refuzojnë këtë qasje.

Gjermania, që drejton presidencën e BE-së që nga korriku, është ajo që mund të diktojë daljen nga ngërçi. Edhe pse Berlioni i nënshtrohet zakonisht Parisit kur është fjala

për politikën në Mesdhe, ai është i prirur ta mbajë Ankarën sa më afër BE-së që të jetë e mundur. Turqia po luan aktualisht me zjarrin.

Nëse shkon shumë larg me veprimet e saj agresive, Bashkimi Evropian, ashtu si edhe Shtetet e Bashkuara, do të rreshtohen plotësisht në anën e Greqisë. Vija e kuqe që Turqia nuk mund ta kapërcejë është Kreta, ujërat jugore të së cilës mendohet se përmbajnë sasi të mëdha të naftës ose gazit natyror.

Megjithëse njihen ndërkombëtarisht si ujëra territoriale grekë, harta Ankara-Tripoli ia njeh këtë zonë Libisë. Nëse Turqia e dërgon anijen e saj të shpimeve pranë brigjeve jugore të Kretës, atëherë gjithçka mund të ndodhë. Por deri më tani, Turqia nuk e ka kapërcyer këtë vijë të kuqe.

Ankaraja mund ta përdorë mundësinë e eksplorimeve në ujërat rrotull Kretës, si një mjet shantazhi në bisedime. Çdo proces serioz i uljes së tensioneve midis Turqisë dhe Greqisë, kërkon një palë të tretë me ndikim të mjaftueshëm për ta nxitur Ankarën dhe Athinën të angazhohen në negociata serioze.

Në këtë drejtim, shenjat më shpresëdhënëse për rajonin janë përpjekjet e fundit konstruktive të Shteteve të Bashkuara, për të arritur krijimin e një zone tampon dhe të armëpushimit në Libi. Lidhja qofte edhe e tërthortë midis konflikteve të ndryshme rajonale, krijon hapësirë për një dialog pragmatik mbi kufijtë detarë në Mesdhe.

Ekziston pra mundësia për të dalë edhe nga kriza aktuale. Dhe kjo mundësi do të kërkojë që SHBA-ja, ndoshta në bashkëpunim me Gjermaninë, të veprojnë me aftësi dhe me një angazhim të fortë diplomatik.

"Foreign Policy" – Bota.al



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

E jashtëzakonshme

Qindra copa të çmuara meteori bien në qytezën braziliane



Mijëra njerëz kanë nisur të shkojnë drejt një qyteti brazilian ku copa materiali të çmuar të një meteori 4.6 miliardë vjeçar po bien nga qielli, disa prej

të cilave vlejnë deri në 25 000 dollarë. Rreth 200 fragmente meteoriiti kanë rënë në Santa Filomena, në verilindje të Brazilit. Më e madhja prej tyre

peshonte 40 kilogramë dhe kishte vlerën 25 000 dollarë. Kjo shumë do të ishte ekuivalentja e dhjetë vjetëve me rrogën mesatare të zonës.

BARSOLETA E DITËS



Babi: Bir, pse qan?

Djali: Pash ëndërr sikur po digjej shkolla.

Babi: Ishte thjesht ëndërr.

Djali: Prandaj po qaj.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje




FOTO E DITES



Nëntë kadetë shqiptarë diplomuan në akademinë ushtarake në Turqi

E rrallë

Gruaja në Indi kërkon divorc: S'kam nevojë për një burrë që pajtohet me mua për gjithçka

Një grua nga India kohët e fundit bëri kërkesë për divorc në një gjykatë, pasi burri i saj e do atë shumë, raporton "Oddity Central". Gruaja e pайдentifikuar nga Sambhal, shteti federal Uttar Pradesh, kohët e fundit bëri thirrje në një gjykatë të sheri-

atit për të kërkuar një divorc nga burri i saj me të cilin ajo është martuar për 18 muaj. E pyetur për ta shpjeguar kërkesën e saj, gruaja tha se burri i saj e do atë shumë dhe kurrë nuk është grindur me të dhe se ajo nuk mund ta pranojë atë.

 <p>DASHI Gjëja e vetme që mund të bëni është që ta braktisni plotësisht monotoninë, të çlodheni, të përjetoni momente intime dhe romantike me partnerin tuaj.</p>	 <p>DEMI Përfitoni nga kjo periudhë për të filluar projekte të reja. Do të jeni shumë produktiv dhe nuk do të mashtroheni nga askush.</p>	 <p>BINJAKËT Në këtë periudhë gjithçka duhet të shkojë mirë: pushimet, marrëdhëniet emocionale, seksi dhe puna. Dhe kjo është një ftesë e qartë për t'i përmirësuar cilësitë tuaja.</p>	 <p>GAFORRJA Dita ideale për të përfunduar atë që ka mbetur nga dembelizmi dhe të vendosni të bëni diçka të veçantë për ditët në vazhdim, siç është futja në një filozofi të re të jetës.</p>	 <p>LUANI Përfitoni nga yjet për ta zgjeruar rrethin e miqësive, bashkëpunimeve dhe për ta forcuar jetën shoqërore. Do të ishte turp nëse do të qëndronit vetëm!</p>	 <p>VIRGJËRËSHA Yjet ju bëjnë thirrje të guxonit, t'i shfrytëzoni mundësitë për të bërë diçka të rëndësishme për të ardhmen ose për ta kërkuar autonominë tuaj. Sfera profesionale është e pasur me stimuj dhe po kështu është edhe jeta shoqërore.</p>
 <p>PESHORJA Një bashkëveprim i mirë ju lidh edhe më shumë me partnerin tuaj, duke dëshmuar se jeni personi ideal për të jetuar së bashku ëndërrat tuaja të dashurisë.</p>	 <p>AKREPI Përpiquni të jeni të qetë dhe ta gjeni ngushëllimin te familja juaj. Klima në shtëpi do të jetë e ngrohtë dhe do t'ju strehojë nga paqartësitë që keni ndaj botës.</p>	 <p>SHIGJETARI Ditë ideale për të qenë në shoqëri, për ta demonstruar kreativitetin dhe për t'u argëtuar. Ju jeni në gjendje të shprehni pa rezerva anët më të mira të personalitetit.</p>	 <p>BRICJAPI Kini kujdes që të mos shkëlqojnë rregullat, jini të kujdesshëm në drejtimin e sporteve dhe lëvizjeve. Në aspektin ekonomik, ndoshta jo sot, por së shpejti do të keni mundësi të merrni atë që meritoni.</p>	 <p>UJORI Vështirimi juaj thotë shumë gjëra, në sytë e tu do të shihet një lumturi e madhe nga pikëpamja sentimentale.</p>	 <p>PESHQIT Ju keni një vizion të qartë se çfarë ka ndodhur, ju mund të shihni qartë se kush ka qenë miku juaj dhe kush ka komplotuar pas jush.</p>

Cardi B dhe Megan Thee Stallion shkruajnë historinë me këngën e re



Cardi B ka pak javë që bashkoi forcat me Megan Thee Stallion për projektin e ri muzikor. “Wap” titullohet bashkëpunimi i dy artisteve, i cili mori komente të shumta pozitive dhe negative. Por, janë tabelat muzikore ato që e trego-


jnë më së miri suksesin e këtij projekti, madje së fundi Cardi B njoftoi se kjo këngë ka shkruar historinë. “Wap” është bërë bashkëpunimi i parë mes dy këngëtareve, i cili thyen rekord në “Spotify”, si kënga më e dëgjuar e ditës.

Justini ndan çaste romantike me Haileyn



Justin Bieber ka ndarë me ndjekësit fotografi të reja në rrjete sociale, në të cilat shfaqet pranë Hailey Biebe. Në këto imazhe këngëtari shihet duke i dhuruar puthje pasionuese gruas, ndërsa në mbishkrimin e njëres fotografi

shkruan “Dashuri”. Ai, po ashtu, publikoi edhe të tjera fotografi, me të cilat tregoi se provoi një aventurë ndryshe dje bashkë me partneren. Çifti ishin veshur me veshje sportive dhe dukeshin shumë të dashuruar me njëri-tjetrin, si zakonisht.



Bella Hadidi vishet nga një stiliste shqiptare

Tashmë nuk kemi pse të çuditemi më, pasi shumë të huaj me famë ndërkom-bëtare po zgjedhin të vishen nga stilistë shqiptarë. Këtë herë është Nensi Dojaka, një stiliste e re dhe shumë e talentuar, e cila është kujdesur ta veshë supermodelen me famë botërore Bella Hadid. Bella u shfaq në ngjarjen e ‘MTV


Video Music Awards 2020’, me një veshje të realizuar nga Nensi. Ka qenë supermodelja ajo e cila nëpërmjet një postimi në “Instagram” ka prezantuar me të gjithë ndjekësit talentin e Nensit. “E veshur nga një stiliste e re shumë e talentuar Nensi Dojaka”, ka shkruar Bella Hadid në përshkrimin e fotove të publikuara.

Stresi gatuan patëllxhan të mbushur dhe hekuros rrobat



Reperi i njohur Stresi gjithmonë është etiketuar si “bad boy” (djalë i keq), megjithëse shpesh shohim shumë anë të mira e të buta të tij. Së fundmi reperi i hitit

“Loco” ka postuar në llogarinë e vet në “Instagram” një fotografi teksa shihet të ketë gatuar patëllxhan të mbushur, si dhe t’i ketë hekuros rrobat e veta.



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Rrahmani dhe Vojvoda paralajmërojnë fitore ndaj Moldavisë

Dyshja e "dardanëve", Amir Rrahmani dhe Mërgim Vojvoda, janë shprehur të lumtur që janë rikthyer pas një kohe të gjatë në përfaqësuese, ndërsa për ndeshjen e Ligës së Kombeve ndaj Moldavisë kanë paralajmëruar fitore. Kosova përballlet më 3 shtator me Moldavinë, kurse më 6 shtator e pret Greqinë në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Kosova ndeshjen e parë të sezonit të ri në Ligën e Kombeve do ta zhvillojë kundër Moldavisë. Kapiteni i "dardanëve", Amir Rrahmani, ka thënë se lojtarët kanë treguar se sa e rëndësishme është të përfaqësohet vendi i tyre, prandaj i janë përgjigjur ftesës për ndeshjen e Ligës së Kombeve. Mbrojtësi i ri i Napolit pret fitore përballë Moldavisë. "Ka kaluar një kohë e gjatë prej kur jemi grumbulluar herën e fundit dhe normalisht që na kanë munguar

këto ndeshje që ta përfaqësojmë vendin tonë. Nuk është e lehtë shkaku i pandemisë dhe natyrisht do të luajmë pa tifozë. Do të jenë ndeshje ndryshe. Shpresojmë t'i kalojmë me sukses. Na duhet rezultat pozitiv. Për këtë arsye kemi ardhur, për këtë kemi rrezikuar, pasi ndoshta disa kur të kthehen do të bëjnë dy javë karantinë, por të gjithë duan ta përfaqësojnë vendin e vet kështu që shpresojmë fillimisht për një rezultat pozitiv me Moldavinë e më pas të bëhemi gati për Greqinë", ka thënë Rrahmani. Për ndeshjen që zhvillohet më 3 shtator ka folur edhe mbrojtësi

Mërgim Vojvoda. Futbollisti që iu bashkua pak ditë më parë skuadrës së Torinos edhe ai kërkon tri pikët e plota. "Emocionet janë të mira si gjithmonë. Na ka munguar shumë Kosova. Jemi në një situatë të jashtëzakonshme, por duhet të ecim para dhe të punojmë, së pari fizikisht e më pas faktikisht. Besoj këto ditë do të punojmë në këto aspekte. Ndeshja kundër Moldavisë dhe Greqisë? Presim fitore. Moldavia normalisht nuk është si Greqia, por është kombëtare e mirë

kështu që duhet të luajmë mirë dhe t'i marrim tri pikët", ka deklaruar Vojvoda. Kosova të martën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" ka zhvilluar edhe përgatitjen e dytë për ndeshjen ndaj Moldavisë.

Kololi e Kryeziu luajnë ndaj Moldavisë

Cyrihu ka lëshuar komunikatë zyrtare sa i përket dyshes Benjamin Kololi dhe Hekuran Kryeziu. Klubi zviceran ka bërë me dije se dyshja do të lejohet t'i

bashkohet kombëtares së Kosovës në ndeshjen e 3 shtatorit kundër Moldavisë në Parma, por në takimin që pritet të luhet në 'Fadil Vokrri' kundër Greqisë tri ditë më vonë, Kololi dhe Kryeziu, pritet të jenë mungesat e tjera të mëdha për selektorin Bernard Challandes. Klubi i Cyrihut e nënvizon faktin se Kosova është një nga zonat më të rrezikshme nga Covid-19 dhe kjo është arsyeja pse klubi nuk i ka lejuar ata edhe për ndeshjen e dytë në kuadër të Ligës së Kombeve që luhet në Prishtinë.

Besa përballlet me Bosna Visokon, Prishtina me Dobrudjan

PRISHTINË, 1 SHTATOR - KH Besa Famgas do të udhëtojë në Bosnjë-Hercegovinë për ta luajtur njëherë ndeshje të raundit të dytë të Kupës Evropiane (European Cup). Klubi pejan përballë do ta ketë klubin Bosna Visoko. Shorti është tërhequr të martën në Vjenë. Bosna Visoko është vendëse në ndeshjen e parë, kurse Besa Famgas në ndeshjen e dytë. Kampionia e Kosovës, Besa Famgas, ka synime për të shkuar larg në Kupën Evropiane. Ndeshjet e para i luan në nëntor. Ndërsa hendbollistët e



Prishtinës do ta luajnë në shtëpi ndeshjen e parë të raundit të dytë të Kupës Evropiane

(European Cup). Përballë Prishtinës do të jetë skuadra bullgare Dobrudja. Kështu është

vendosur me shortin e tërhequr të martën në Vjenë. Prishtina kthehet në gara evropiane dhe ka pretendime për hapa më

tutje. Shorti nuk e penalizon në këtë synim. Prishtina ndeshjet e para në Kupën Evropiane i luan në muajin nëntor.

Vushtrria e Istogu përballen në Kupën Evropiane

Vushtrria e Istogu do të përballen mes vete në raundin e dytë të Kupës Evropiane (European Cup) në konkurrencë të femrave. Kështu është vendosur me shortin e tërhequr të martën në Vjenë të Austrisë. Vushtrria do të jetë vendëse në ndeshjen e parë,

ndërsa Istogu në ndeshjen e dytë. Është hera e parë që dy skuadra përballen mes vete në gara evropiane. EHF-ja, pas situatës së krijuar me Covid-19, ka bërë të mundur që edhe skuadrat nga i njëjti vend të luajnë mes vete. Ndeshjet luhen në tetor.

Muriqi: Dua t'i bashkohem Lazios

STAMBOLL, 1 SHTATOR - Sulmuesi i Përfaqësues së Kosovës, Vedat Muriqi, dëshiron të transferohet në skuadrën e Lazios dhe një gjë të tillë ia ka thënë edhe skuadrës së Fenerbahçes. Marrëveshja midis klubeve është afër, por ende duhet të punohet për ta gjetur marrëveshjen përfundimtare. Sulmuesi "dardan" foli për gazetarin Ertan Suzgun: "Fenerbahçe ka një vend të veçantë tek unë. Unë dua të largohem këtu me

elegancë, pa prishur raportet. Unë kurrë nuk kam kryer negociata që nuk ishin në përputhje me interesat e klubit". Pastaj Muriqi flet drejtpërdrejt për Lazion dhe u dërgon një mesazh menaxherëve të klubit turk: "Lazio luan në Serinë A dhe luan në Ligën e Kampioneve. Është një hap i rëndësishëm në karrierën time. Sidoqoftë, negociatat po zgjasin shumë dhe kjo ka filluar të më shqetësojë... është rraskapitëse.

Ata mund të më shesin për gjashtë herë më lart se çmimi i blerjes. Unë dua që kjo negociatë të përfundojë sa më shpejt të jetë e mundur". Lazio po bën presion për ta mbyllur marrëveshjen dhe për ta kënaqur lojtarin. Kanë mbetur vetëm disa hapa para se të arrijnë te finalizimi i transferimit, me kusht që Fenerbahçe të mos vendosë të ndërtojë mure të reja dhe ta zgjasë telenovelën për një kohë të pacaktuar.



Drenica transferon Muratin dhe Ollurin, rinovon me Thaqin

SKENDERAJ, 1 SHTATOR - KF Drenica ka prezantuar të martën dy futbollistë të ri, derisa ka vazhduar kontratën me një tjetër futbollist. Sulmuesi Almedin Murati dhe mesfushori Gentrit Olluri janë veshur me ngjyrat kuqezi, kurse besnik këtyre ngjyrave i

ka qëndruar edhe Arbios Thaqi, i cili edhe një vit tjetër do të jetë pjesë e Drenicës. "Në ambientet e KF Drenica sot është prezantuar sulmuesi Almedin Murati. Sulmuesi ishte pjesë e shumë skuadrave të Kosovës, ndër to edhe Vëllaznimit dhe Dritës, kurse

së fundmi ishte pjesë e KF Besa. Gjithashtu, është arritur marrëveshja edhe me një lojtar tjetër, fjala është për Gentrit Ollurin. Ky i fundit ishte pjesë e Ramiz Sadikut, kurse roli i tij është mesfushor dhe qendërbrojtës. Olluri, po ashtu, ka nënshkruar kon-

tratë me klubin. Ndërkohë Arbios Thaqi ka arritur marrëveshje me drejtuesit e klubit për vazhdimin e kontratës edhe për një vit tjetër. Thaqi tashmë do të jetë i gatshëm të vihet nën urdhrat e trajnerit Fadil Rama", thuhet në njoftimin e Drenicës.



Stubulla: Nuk mund ta paramendoj jetën pa basketboll

PRISHTINË, 1 SHTATOR - Një nga basketbollistët e gjeneratës së artë të Prishtinës është Shemsije Stublla. Ajo ka luajtur për Universitetin e Prishtinës deri në vitin 1989 për t'u transferuar më pas në Maribor. Ajo ka qenë lojtare aktive deri në vitin 2000, ndërsa tani jeton dhe vepron në Slloveni. Stublla në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së ka treguar si filloi të merret me basketboll, ndeshjen e paharrueshme, trofeun më të çmuar dhe mesazhin për vajzat e reja që duan të merren me basketboll.

Si vendose të luaje basketboll?

Stublla: Rruga e basketbollit për mua ka filluar nga shkolla fillore. Kam luajtur për ekipin e shkollës i cili bënte gara në ligën e shkollave të qytetit. Kjo ligë ka qenë shumë cilësore dhe nga këtu ka dalë një numër mjaft i madh i basketbollistëve të dalluara.

Cili ka qenë idhulli yt në fëmijëri?

Stublla: Ndoshta duket e çuditshme, por nuk kam pasur ndonjë idhull, edhe pse me kënaqësi i kam përcjell pothuajse të gjitha ndeshjet basketbollistike të ligës së parë federative si dhe ato të reprezentacionit të asaj kohe.

Cili ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?

Stublla: Secili trofe e ka peshën e vet, secili përmban në vete një tregim dhe ngjarje të caktuar. Do ta veçoj turneun ndërkombëtar në vitin 1990 me ekipin e Mariborit në Marburg të Gjermanisë ku u zgjodha lojtareja më e mirë si dhe realizatorja më e mirë në një konkurrencë mjaft të fortë.



Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?

Stublla: Në karrierën time ka pasur shumë ndeshje interesante. Nuk do ta harroj kurrë ndeshjen Universiteti - Bosna në vitin 1987 të vlefshme për kualifikim në Ligën e Parë të ish-Jugosllavisë, të cilën e fituam bindshëm dhe u kthyem aty ku e kishim vendin edhe më parë.

Cili ka qenë kundërshtari më i vështirë që je ballafaquar?

Stublla: Kundërshtari më i vështirë për mua dhe për ekipin e Universitetit mendoj që kanë qenë gjyqtarët. Kemi përjetuar padrejtësi shumë të mëdha në referim, sidomos në ndeshjet jashtë Prishtinës.

Sa të mungon basketbolli dhe atmosfera nga koha kur ke luajtur?

Stublla: Unë edhe sot merrem me

basketboll. Jeta ime është e lidhur ngushtë me këtë sport prandaj nuk mund ta paramendoj jetën pa basketboll. Në mënyrë rekreative ushtroj dy herë në javë me ekipin qytetit ku unë jetoj. Deri më tani kam marrë pjesë në disa Kampionate Evropiane dhe Botërore për Veterane. Po ashtu jam edhe e angazhuar si trajnere e ekipit të vajzave të grupmoshave të reja.

Cili është mesazhi për lojtaret e reja që duan të merren me basketboll?

Stublla: Ato vajza të cilat e duan basketbollin dhe dëshirojnë të merren me këtë sport i kisha këshilluar që ta ndjekin ëndrrën e tyre dhe mos të dorëzohen. Në kohën time një ëndërr e tillë ka qenë sfidë shumë të madhe për tu realizuar, por me dëshirë dhe vullnet ja kam arritur. Kurse ju sot do ta keni shumë më lehtë.

Miami befason Milwaukeeen në gjysmëfinalen e parë, Thunderi ndali Houstonin



ORLANDO, 1 SHTATOR - Miami ka fituar 115-104 ndaj Milwaukeees në gjysmëfinalen e parë "play-off" mes dy ekipeve në Konferencën e Lindjes, duke udhëhequr 1-0 me ndeshje. Një rezultat disi surprizë, pasi Bucks konsiderohet favorit, por Heat luajti më mirë, sidomos në pjesën e dytë.

Antetokounmpo nuk dha më të mirën në fushë (18 pikë e 10 rebounde), ndërkohë që për Bucksin u dalluan Middletoni me 28 pikë e Lopezi me 24 pikë. Për Miamin shkëlqeu Jimmy Butler, që realizoi 40 pikë, mbështetur nga Dragicu me 27 pikë. Situata ende e hapur në Perëndim për sa i përket dy

ekipeve të fundit gjysmëfinaliste. Oklahoma fitoi 104-100 ndaj Houstonit në çerekfinalen e gjashtë, duke barazuar 3-3 serinë e ndeshjeve, ku të dyja ekipet luajtën mirë, por në minutat e fundit triumfoi skuadra e Thunderit falë 28 pikëve të Paulit dhe 25 të Gallinarit. 32 pikët e Hardenit për teksanët mbetën për statistikë.

Konferenca e Lindjes

Milwaukee - Miami	104-115 (0-1)
Boston - Toronto	(1-0)
Konferenca e Perëndimit	
Lakers - Portland	(4-1)
Clippers - Dallas	111-97 (4-2)
Denver - Utah Jazz	119-107 (3-3)
Houston - Oklahoma	100-104 (3-3)

SHKURT

Bërbatovci rikthehet te KEK-u

Florim Bërbatovci është rikthyer dhe zyrtarizuar te skuadra e KEK-ut. Lajmi është dhënë në faqen zyrtare të Klubit nga Kastrioti. "Bordi është duke punuar në mënyrë të përkryer për sezonin e ri. Kësisoj, kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë që kemi përfunduar marrëveshjen me sulmuesin e njohur Florim Bërbatovci", thuhet në njoftimin e skuadrës KEK-ut. Bërbatovci formën më të mirë e kaloi pikërisht në këtë klub, kurse në kampionatin e kaluar ishte pjesë e Besës së Pejës.

Rakitiqi rikthehet te Sevilla

Mesfushori Ivan Rakitiqi është rikthyer te Sevilla. Mesfushori kroat që gjashtë vjet ishte pjesë e Barcelonës, kurse për skuadrën e re ka nënshkruar kontratë katërvjeçare. 32-vjeçari me Barcelonën është paraqitur në 310 ndeshje, kurse ka realizuar 35 gola.

Vazhdon 'mallkimi' për Traoren

Futbollisti Adama Traore ka rezultuar pozitiv pas testit ndaj Covid-19. Ylli i Wolverhamptonit u grumbullua për herë të dytë me kombëtaren iberike, por është larguar. Traore është grumbulluar edhe një herë tjetër me Spanjën por, për shkak të dëmtimit, u largua. Këtë herë ka qenë virusi famëkeq që ka ndaluar Traoren të luajë për Spanjën.


Ozili, afër largimit nga Arsenali

Mesfushori Mesut Ozil është afër largimit nga skuadra e Arsenalit, njofton "Daily Mail". Për mesfushorin 31-vjeçar interesim ka shfaqur skuadra e Al-Nassr, e cila është gati ta paguajë mesfushorin 15 milionë stërlina në sezon. Ozili që ka luajtur edhe për Real Madridin ka kontratë edhe një vit me Arsenalin, prandaj klubi anglez po synon ta shesë sa më parë në mënyrë që ai mos të largohet me parametra zero.

Di Maria dhe Paredes infektohen me Covid-19

Angel Di Maria dhe Leandro Paredes mund të jenë dy futbollistët e infektuar me koronavirus. Mediat franceze bëjnë me dije se dy lojtarët e nënkampionëve të Evropës, të cilët u raportuan se ishin infektuar me koronavirus, janë dy argjentinasit Di Maria dhe Paredes. Sipas "RMC Sport", të dy lojtarët janë infektuar në Ibiza të Spanjës gjatë pushimeve pas humbjes së trofeut të Ligës së Kampionëve kundër Bayern Munchenit. Dy futbollistët nuk do të luajnë në ndeshjen e parë të kampionatit kundër Lensit më 10 shtator pasi duhet të izolohen.

Komuna e Gjakovës
 Opština Gjakovë / Gjakova Municipality
 N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
 GJAKOVË
 Nr.: 267
 Datë: 01.09.2020



N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
GJAKOVË

KE: 0390/320 010
E-mail: nplstg@gmail.com
Info: 0390/324 268
Web:

Nr. Biznesit: 71228673
Nr. Fisikal: 601568233
Nr. TVSH: 330311953
BEK: 140200001784638

Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Porcedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Rregullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve dhe neni 15 pika 19 të Rregullores nr.121 të dt.04.04.2016 për Organizimin e Mbrendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësisë të Stafit Punues, dhe vendimit nr.267 të datës 01.09.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L."Stacioni i Autobusëve" SH.A. Gjakovë, shpallë këtë:

KONKURS

Pozita: Kopshtar-Pastrues

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohë zgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Mirëmbanë dhe bënë çdo ditë pastrimin e nevojshëm të të gjitha hapsirave jashta dhe brenda ndërtesës që disponon Ndërmarrja;
- Ujit dhe mirëmban të gjitha hapësirat e gjelbëruara të cilat gjenden brenda dhe përreth objektit të Ndërmarrjes;
- Pastron dhe mirëmban obrorin , peronët dhe hapësirat e shfrytëzuara nga operatorët ;
- Mbanë pastërtinë dhe përkujdeset për të gjitha pajisjet që të jenë në vendin e duhur, brenda dhe jashta objektit;
- Përkujdesje të veçant mbanë rreth mirëmbajtjes dhe zhvillimit të gjelbrimit në të gjitha hapsirat e Ndërmarrjes.
- Kryen punë dhe detyra të tjera të caktuara nga Shefi i Stacionit dhe KE.

Kushtet për pjesëmarrje :Kualifikimi dhe Aftësitë:

- Të kenë të kryer arsimin e mesëm,
- Të kenë sëpaku 1 vjet përvojë pune përkatëse;

Dokumentacioni i kërkuar:

- Diploma mbi shkollimin.
- Dëshmimbipërvojën e punës.
- Kopja e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj;

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjestarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni përpunësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2.


Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kati II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 14:00. Konkursi është për 15 ditë i hapur nga data 02.09.2020 – 16.09.2020.



Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta hudhen poshtë.

Gjakovë, më 01.09.2020

Kryeshefi Ekzekutiv – F. [Signature]



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

13/522
01.09.2020

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

NJOFTIM PËR PËR ANULIM TË PJESËRISHËM TË KONKURSTIT

Në konkursin e shpallur me datë 27.08.2020 me nr.prot.13/454 dhe publikuar në gazetën "Epoka e Re" me datën 28.08.2020 faqe 20, është lëshuar një gabim teknik gjatë llogaritjes së normës mësimore dhe pozita ; Një mësimdhënësi i historis (10 orë) anulohet.

Datë:01.09.2020
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

- ▶ Revzat Bajra shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Ekrem Rexha Drini " Lubizhd.
- ▶ Ajdar Saramati shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Heronjtë e Lumes" Vermic.
- ▶ Dzevahir Sagdati shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Meto Bajraktari " Reçane.
- ▶ Urim Rramanaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Naim Frasheri " Vlashnje .
- ▶ Lëshoj banës me qira në Prishtinë, banesa është në qendër, përballë EULEX-it rruga "Luan Haradinaj". Banesa është 80m2 e mobiluar me nxehe qendrore. Çmimi 250 Euro. Tel: 044-171-328.
- ▶ Avni Isuf Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike "28 Nëntori" Prishtinë.
- ▶ Bali Salih nga fshati Ticë shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore SHFMU "Ismet Uka" Ticë Skenderaj.
- ▶ Zyrafete Imer Dani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Ismet Uka" Ticë, Skenderaj klasa I-VIII.

- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

Një javë pa më të dashurin tonë



Jahir Halil Kastrati

(1940-2020)

Baba, gjysh, bacë, vjehërr, e kemi goxha vështirë ta shkruajmë këtë përkujtim në javën e parë të vdekjes tënde. Njëzëri, kur po i jepnim njëri-tjetrit lajmin për humbjen tënde dhe po shprehnim ngushëllime më të vjetërve, thamë se ne nuk humbëm më të dashurin tonë, por edhe më të respektuarin në familjen tonë nga rrethi i ngushtë dhe i gjerë familjar, edhe nga ai miqësor dhe shoqëror. Pa ty familja më nuk është si ka qenë. As katundi jo. Kemi plagë të madhe në shpirt, babë. Fryma e shtëpisë ishte ti dhe do të përpiqemi të të nderojmë shumë sepse ti dije ta doje, ta nderoje dhe të respektoje secilin njeri.

Kudo që flitet sot për ty, pas vdekjes tënde, flitet për një njeri me vlera të larta njerëzore, për një njeri të ndershëm e të respektueshëm e zotëri të madh. Ata që i doje dhe të donin, vazhdojnë të na duan sot edhe më shumë dhe të na respektojnë për shkak të nderit që ua ke bërë ndër vite. Shumë prej miqve të tu, sapo morën lajmin për vdekjen tënde, na shprehën ngushëllime nga anë të ndryshme të botës dhe ndan me ne dhimbjen dhe mërzinë, duke kujtuar çaste të ndryshme nga takimet me ty. Prehu në paqe, njeri i mirë dhe i dashur!

E përkujtojnë, me mall të pashuar, djemtë me familje: Hashimi, Kadriu, Besimi, Avniu, Naimi nga Turjaka e Malishevës.